



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	16.11.2023	3	viti god year
Organ /Mjesta Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/SHOK	6995/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1235/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1235/2023 të datës 02.10.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit të datës 31.08.2023 të Kryetarit të Komunës së Lepasaviqit, në çështjen juridike "masë disiplinore-ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 15.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.1235/2023 e datës 02.10.2023 e parashtruar nga ankuesja

II. Anullohet Vendimi i datës 31.08.2023 i Kryetarit të Komunës së Lepasaviqit.

III. Obligohet Kryetari i Komunës së Lepasaviqit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimet të tij, duke e kthyer ankuesen në vendin e punës në pozitën Zyrtar për Ndihmë Sociale-Pedagog sipas Akt Emërimit me Nr. 159/1 të datës 15.05.2020, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me marrëdhënien e punës, duke bërë kompensimin e të gjitha pagave nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi, si dhe të bëjë heqjen e masës disiplinore nga dosja personale e ankueses.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses e punësuar sipas Akt Emërimit me Nr. 159/1 të datës 15.05.2020 në pozitën “Zyrtar për Ndhimë Sociale-Pedagog”, në Komunën e Leposaviqit më datë 31.08.2023 Kryetari i Komunës së Leposaviqit ka nxjerr Vendim për suspendimi nga vendi i punës, me arsyetimin se *nga data 07.07.2023 e njëjta ka munguar në vendin e saj të punës, kështu që nuk ka kryer detyrat dhe obligimet në vendin e saj të punës., dhe më këtë ka kryer shkelje në pajtim me nenin 27 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë. Gjithashtu e njëjta nuk ka përmbushur obligimet e saj në përputhje me aktin e emërimit të saj duke e mbajtur Qendrën e mbyllur me dry dhe pa mbishkrim identifikimi. Gjithashtu ka refuzuar vendimet e kryetarit të komunës duke mos respektuar drejtoreshën e sapoemëruar në Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mbrojtje Sociale.*

Ankuesja kundër Vendimit të datës 31.08.2023 të Kryetarit të Komunës së Leposaviqit, përmes postës më datë 28.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është në Këshill është pranuar më datë 02.10.2023 nën shenjen A.nr.1135/2023 me numër protokolli 6348/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, më datë 07.09.2023 ka njoftuar Kryetarin e Komunës së Leposaviqit, për pranimin e ankesës së ankueses duke kokrruar që të njoftoj se kush është Udhëheqës i Personelit me qëllim të komunikimit të mëtutjeshëm për sigurimin e provave nga komuna si palë në procedurë, mirëpo nuk kemi marr asnjë përgjigje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën e datës 02.10.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 31.08.2023 të Kryetarit të Komunës së Leposaviqit; Autorizimin e datës 26.09.2023; Procesverbali i datës 07.07.2023; Formulari A3, kërkesë nr.325798 të datës 10.07.2023; Formulari A-3 kërkesë nr.326122 të datës 12.07.2023; Formulari D-1 vërtetimi për parashtrimin e kërkesës për ndihmë sociale, kërkesë nr.326547 të datës 13.07.2023; Formulari D-1, vërtetimi për paraqitjen e kërkesës për ndihmë sociale nr.326650; Procesverbali i datës 14.07.2023; Formulari D-1, vërtetimi për paraqitjen e kërkesës për ndihmë sociale nr. 326716; Procesverbali i datës 18.07.2023 mbi dëgjimin e palës në objektin e Qendrës për Punë Sociale në Leposaviq; Formulari D-1, vërtetimi për paraqitjen e kërkesës për ndihmë sociale nr. 326874 të datës 02.08.2023; Formulari A-3 për llogaritjen e ardhurave dhe mjeteve materiale dhe jo-materiale nr.326874 të datës 02.08.2023; Formulari D-1, vërtetimi për paraqitjen e kërkesës për ndihmë sociale; Aktvendimi mbi refuzimin e kërkesës, i pranuar më 07.08.2023 nga parashtruesi i kërkesës; Aktvendimi mbi refuzimin e kërkesës i pranuar më 11.08.2023. nga parashtruesi i kërkesës; Procesverbali i datës 17.08.2023 lidhur me dëgjimin e palës në objektin e Qendrës për punë sociale në Leposaviq; Vërtetimi i datës 29.08.2023, pranuar nga parashtruesi i kërkesës në datën e mësipërme; Procesverbali i datës 30.08.2023, lidhur me një deklaratë në procesverbal të përfituesit; Kopje e librit të regjistrimit me datat prej 04.07.2023 deri më 30.08.2023; Lista e ardhjeve të punëtorëve në Qendrën për punë sociale Leposaviq për muajin korrik dhe gusht; Akt emërim për _____ nr.159/1 të datës 15.05.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e bazuar, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 31.08.2023 të Kryetarit të Komunës së Leposaviqit, pretendon se ky vendim është nxjerr si rezultat i shkeljeve procedurale dhe materiale ngase Kryetari i Komunës nuk ka kompetencë të nxjerr vendim për suspendim nga marrëdhënia e punës sepse nëse dyshohet për shkelje të supozuara disiplinore rasti duhet të trajtohet nga Komisioni Disiplinor, rrjedhimisht Kryetari i Komunës ka keqinterpretuar nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Kolegji i Këshillit, në shqyrtim të pretendimeve ankimore dhe veprimet të ndërmarra në lidhje me marrëdhënien e punës së ankueses, konstaton se sipas Akt Emërimit me Nr. 159/1 të datës 15.05.2020, ankuesja ka statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës bëhet vetëm sipas këtij ligji siç është përcaktuar me nenin 32 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"1. Marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunësit civil (në vijim: marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil) është marrëdhënie juridike e së drejtës administrative. 2. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil themelohet me aktin e emërimit dhe, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj, është e përhershme (me afat të pacaktuar). 3. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji"*.

Pretendimet për mos prezencë në punës apo mos respektim të orarit të punës, për mos përmbushje të obligimeve në përputhje me aktin e emërimit, pretendimet për refuzim të vendimeve të kryetarit të komunës duke mos respektuar drejtoreshën e sapoemëruar në Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mbrojtje Sociale janë pretendime që nëse ka prova materiale konsiderohen shkelje disiplinore të bërë nga nëpunësi civil, si rrjedhojë nëse nëpunësi civil nuk i përmbahet dispozitave ligjore në fuqi për shërbimin civil atëherë ai duhet t'i nënshtrohet masave disiplinore të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me përgjegjësin disiplinore Kolegji i Këshillit i'u referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht:

Nenit 45 ka përcaktuar se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*.

Nenit 46 ku citohet se: 1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta...Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasojë të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në

legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë”, ndërsa Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.

Bazuar në këto dispozita, Kolegji i Këshillit konstaton se për të ekzistuar masa disiplinore duhet të plotësohet kushtet ligjore të përcaktuar me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, po ashtu nëse dyshohet se nëpunësi civil ka bërë shkelje disiplinore, fillimisht mbikëqyrës i drejtpërdrejtë duhet të bëjë kualifikimin e shkeljes disiplinore a është shkelje e rendë apo shkelje e lehtë disiplinore dhe varësisht nga ky kualifikim duhet të përcaktuar se cilat janë shkeljet e bëra e që janë të përcaktuar në detaje me nenin 46 të këtij ligji, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se nëse mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil apo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil bënë kualifikimin e drejtë të shkeljeve disiplinore sipas dispozitave të cekura më lartë, mund të filloj procedurë disiplinore ndaj nëpunësit civil, çoftë përmes shqiptimit të masës së lehtë disiplinore e cila bien në kompetencë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt apo mund të inicioj procedurë disiplinore pranë Komisionit Disiplinor.

Bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: “1. Në çdo institucion, në fushën e veprimit të këtij ligji, themelohet një komision disiplinor me mandat 3 vjeçar, që përfshin së paku një përfaqësues të njësisë përgjegjëse”, ndërsa paragrafi 6 i këtij neni, ka përcaktuar se: “6. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për themelimin, përbërjen, përzgjedhjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor dhe në Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, në përputhje me rregullat e përgjithshme të përcaktuara në Ligjin për Procedurat e Përgjithshme Administrative”, kështu që në kuptim të zbatimit të kësaj norme është aprovuar Rregullorja (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, e cila me nenin 1, ka përcaktuar se: “Kjo Rregullore përcakton, procedurat dhe masat disiplinore për nëpunësit civil, themelimin, përbërjen dhe përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit disiplinor, si dhe ankesat e nëpunësve civil me rastin e shqiptimit të masave disiplinore, në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë (në tekstin në vijim : Ligji)”.

Duke marr për bazë dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më nenin 47 janë përcaktuar se cila masa mund të zbatohet ndaj nëpunësit civil, e që është përcaktuar se: “Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”, ndërsa me nenin 48 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji, është përcaktuar se: 1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor”, si rrjedhojë për shkelje të lehta aplikohet masa disiplinore e paraparë me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa për shkelje të rënda aplikohen masat disiplinore të përcaktuar me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji i Këshillit, ka analizuar dispozitat e nenit 59 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili rregullon mënyrën e përfundimit të marrëdhënies së punës në shërbimin civil, duke përcaktuar

se: 1. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon, si në vijim: 1.1. për shkaqet e përcaktuara në neni 60 të këtij ligji; 1.2. me lirim nga Shërbimi Civil sipas neneve 61 dhe 62 të këtij ligji; dhe 1.3. largimi nga Shërbimi Civil, si masë disiplinore në përputhje me këtë ligj”, si rrjedhojë janë analizuar edhe dispozitat e nenit 60 dhe 61 të këtij ligji, e që kanë të bëjnë me përfundimin e marrëdhënies së punës respektivisht lirim nga shërbimi civil.

Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të konstatuar me ankesë respektivisht Vendimit e datës 31.08.2023 të Kryetarit të Komunës së Leposaviqit dhe në bazë të dispozitave të lartcekura, konstaton se nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore për suspendimin e marrëdhënies së punës së ankueses, ngase Kryetari i Komunës nuk ka asnjë kompetencë ligjore të bëjë ndërprerjen e marrëdhënies së punës ndaj nëpunësit civil nëse nuk plotësohen kushtet ligjore, pasi që nëse ka elemente të shkeljeve të rënda disiplinore fillimisht rasti duhet të trajtohet nga Komisioni Disiplinor, edhe pse sipas Vendimit të datës 31.08.2023 të Kryetarit të Komunës së Leposaviqit supozimet mbi veprimet e ankueses rezultojnë të jenë shkelje të rënda disiplinore, mirëpo nuk janë ndërruar asnjë nga veprimet e lartcekura ligjore, si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit, konstaton se ky vendim është nxjerr nga organi jo kompetent dhe i njëjti përveç që është në kundërshtim me dispozitat e cekura më lartë si dhe nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: “1. Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë”, i njëjti është në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj”, po ashtu është i paligjshëm në kuptim të nëntin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase dispozitat e nenit 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale edhe pse i jep të drejtë Kryetarit të komunës të nxjerrë urdhëresa dhe vendime brenda fushës së kompetencave të tij, kjo nuk nënkupton që sipas këtij neni Kryetari i Komunës mund të përfundoj marrëdhënien e punës së nëpunësit civil pa u ndjekur procedurat e tjera ligjore të aplikueshme për nëpunësit civil sipas ligjit material, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara.

Nga të cekurat si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se Kryetari i Komunës së Leposaviqit, është i obliguar që ankuesen të kthej në vendin e punës në pozitën Zyrtar për Çështje Sociale sipas Akt Emërimit me Nr. 155/1 të datës 15.05.2020, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me marrëdhënien e punës, duke bërë kompensimin e të gjitha pagave nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi, si dhe të bëjë heqjen nga dosja personale masën disiplinore.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1235/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankueses
- Kryetarit të Komunës së Leposaviqit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.